



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 07 Korrik 2021

Nr: 100

VENDIMI

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 57, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN
05.07.2021

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 07.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Kryesues
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijar RUSMALI - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Z. Andi Derhemi.

PALE E INTERESUAR: “Albpetrol” sh.a, përfaqësuar me autorizimin me nr. 4608 prot., datë 06.07.2021 nga zj. Enisa Cepele dhe zj. Rezarta Sinanaj.

OBJEKTI: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 57, të z. Andi Derhemi me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 420, datë 29.06.2021, ‘Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndaj “Albpetrol sh.a”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 133, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë



06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Rrethanat e çështjes:

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar një kallëzim me nr. 5504 prot., datë 27.05.2021, nga një denoncues, me objekt “Ndërprerja e marrëdhënies së punës”, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Sipas denoncuesit pretendohet se: “Është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, brenda periudhës së fushatës zgjedhore, përkatësisht ka marrë njoftimin në datë 29.03.2021, me shkresën nr. 2143 prot., të lëshuar nga administratori i Albpetrol sh.a, z. Flamur Mato. Ky njoftim është në shkelje të nenit 3, pika 1.3, shkronja “d” të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 420, datë 29.06.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Albpetrol Sh.a, ka vendosur përfundimin e shqyrtimit administrativ të Kallëzimit ndaj Albpetrol Sh.a me arsyetimin se organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, është gjykata.
3. Në datën 05.07.2021 ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, z. Andi Derhemi. Objekti i ankimit është:
 - a) kundërshtimi i vendimit nr. 420, datë 29.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - b) shpalljen se njoftimi “mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, më datë 29.03.2021 të lëshuar nga administratori i Albpetrol sh.a, është në shkelje të nenit 3, pika 1.3, shkronja “d”, e vendimit nr.9, datë 24.12.2021 të Komisionit Rregullator.
4. Ankimi iu paraqit KAS-it, i cili caktoi relator z. Elvin Lako dhe vendosi zhvillimin e seancës për shqyrtimin e kërkesës ankimore në datën 07.07.2021, ora 9:00, duke thirur në seancë ankuesin dhe palëm e interesuar shoqërinë Albpetrol sh.a. Seanca u zhvillua në praninë e ankuesit, personit të interesuar dhe të përfaësuesve të administratës së KQZ-së.
5. Në seancë publike për shqyrtimin administrativ të kësaj kërkesë ankimore, KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi provat:



- Kërkesën Ankimore nr.57, datë 05.07.2021 të depozituar nga z. Andi Derhemi;
- Vendimin nr.420, datë 29.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Shkresën nr.5504 prot., datë 27.05.2021 “Kallëzim për veprime të Institucioneve publike në kundërshtim me Kodin Zgjedhor” – Albpetrol Sh.a;
- Shkresa Albpetrol Sh.a me nr.2143 prot., datë 29.03.2021 “Mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” drejtuar z. Andi Derhemi;
- Shkresa KQZ-së me nr.5635 prot., datë 3.06.2021 “Kërkesë për Informacion” drejtuar Administratorit të Albpetrol Sh.a;
- Shkresa e administratorit Albpetrol Sh.a me nr. 5635/1 prot., datë 11.06.2021 kthim përgjigje;
- Shkresa Albpetrol Sh.a me nr.415, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e strukturës organizative;
- Urdhër Alb petrol Sha.a nr.15, datë 11.01.2021 “Mbi njohjen dhe zbatimin e specifikimeve të strukturës Organizative të Shoqërisë Albpetrol Sh.a;
- Shkresa Albpetrol Sh.a me nr.1903 prot., datë 17.03.2021 “Njoftim për zhvillimin e një takimi për të diskutuar në lidhje me marrëdhënien kontraktuale të punës;
- Procesverbali Albpetrol Sh.a me nr.2045 prot., datë 24.03.2021;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Neni 3, pika 1.3, shkronja “d” i vendimit nr. 9/2020 ka përcaktua se “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:

“Gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti



publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “**gjatë fushatës zgjedhore**” dhe në kundërshtim me **rastet e përlijtura** të parashikuara në nenin 3, pika 1.3, shkronja “d” të Vendimit nr.9n datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Referuar nenit 77, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Pra, fushata zgjedhore ka filluar në datën 23.03.2021 dhe ka mbaruar në datën 23.04.2021. Referuar shkresës nr.1903, prot., datë 17.03.2021 rezulton se “njoftimi për zhvillimin e një takimi për të diskutuar në një lidhje me marrëdhënien kontraktuale të punës” ka filluar në datën 17.03.2021, përpara fillimit të fushatës zgjedhore.

2. Nga shqyrtimi i provave rezulton se ndryshimi i strukturës Albpetrol Sh.a, apo shkresa për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nuk ka të bëjë me veprimtari të ndaluara sipas nenit 3, pika 1.3 shkronja “d” të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator. Gjatë shqyrtimit të seancës anëtarët e KAS-it i’u drejtuan disa pyetje z. Derhemi, i cili me pretendimet e tij nuk arriti të provonte se njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është veprimtari e ndaluar dhe të jetë në kundërshtim me vendimin nr.9/2020 të Komisionit rregullator.
3. Z. Derhemi është komanduar në pozicionin e punës si drejtor i Drejtorisë së Prodhimit të Albpetrol sh.a, në datën 09.05.2019. Struktura e Albpetrol sh.a e cila ka qenë e miratuar dhe funksionale në këtë kohë, kishte si detyrim që drejtori i Drejtorisë së Prodhimit të kishte arsimin e lartë duke mos e specifikuar llojin e arsimit. Pra kryerja e funksioneve të drejtorit të Prodhimit nga z. Derhemi ka qenë jo përfundimtare, por e përkohshme. Gjithashtu, nuk u provua dhe as u pretendua se heqja nga pozicioni i punës së z. Derhemi të jetë bërë për arsye elektorale.
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në arsyetimin e tij ka vlerësuar drejtë se ndërprerja e marrëdhënieve të punës, referuar ligjit nr. 9125, datë 29.07.2021 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, është gjykata.



PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 30, të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 57, datë 05.07.2021, të paraqitur nga z. Andi Derhemi.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 420, datë 29.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Albpetrol Sh.a".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve, nga shpallja e tij.

Elvin	LAKO	-	Kryesues
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar (Kundër)
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (Kundër)

MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 57, të subjektit z. Andi Derhemi me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 420, datë 29.06.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator”, ndaj “Albpetrol sh.a”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të paraqitur në KQZ në datën 05.07.2021, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e ankimit, ndaj paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim:

1. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS), nuk ka arritur në një konkluzion të drejtë duke vendosur rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 420, datë 29.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke konsideruar se zgjidhja e kontratës së punës për ankuesin Andi Derhemi nuk është kryer gjatë fushatës zgjedhore dhe në kundërshtim me rastet e përligjura të parashikuara në nenin 3, pika 1.3, shkronja “d”, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator e për rrjedhojë nuk jemi në kushtet e veprimtarisë së ndaluar.
2. Po ashtu, edhe përfundimi i arritur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve se *“Referuar objektit të kallëzimit për “Ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga ana e tij, pikërisht për shkak të mungesës së kompetencës së tij lëndore. Referuar ligjit nr. 9125, datë 29.7.2003 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, është gjykata kompetente”* është një përfundim i gabuar. Në lidhje me këtë arsyetim i referohemi *mutatis mutandis* vendimit unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me anë të të cilit kanë unifikuar se *“... gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar”*.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe KAS duhet të merrnin për bazë veprimtarinë e shoqërisë “Albetrol” sh.a. kundrejt ankuesit Andi Derhemi në raport me nenin 91, pika 3, të



K. Zgjedhor¹ dhe nenin 3 pika 1.3 shkronja “d” të vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”² të Komisionit Rregulator pranë KQZ.

4. Shumica e anëtarëve të KAS pranojnë se në zbatim të K.Zgjedhor “... fushata zgjedhore ka filluar në datën 23.03.2021 dhe ka mbaruar në datën 23.04.2021”, por ndërkohë argumentojnë se “Referuar shkresës nr.1903, prot., datë 17.03.2021 rezulton se “njoftimi për zhvillimin e një takimi për të diskutuar në një lidhje me marrëdhënien kontraktuale të punës” ka filluar në datën 17.03.2021, përpara fillimit të fushatës zgjedhore”.
5. Për ne anëtarët e pakicës, zgjidhja e kontratës së punës nuk duhet të konfondohej me njoftimin me shkrim ndaj punëmarrësit në zbatim të pikës 1 të nenit 144. Zgjidhja e kontratës së punës është procedura e parashikuar nga pika 3 e nenit 144, të K. Punës, dispozitë kjo që parashikon se “Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operacionale të ndërmarrjes”. Në raport me procedurën e ndjekur nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., zgjidhja e kontratës së punës në kuptim të pikës 3 të nenit 144, të K. Punës, është materializuar nëpërmjet shkresës “Njoftim” me Nr. 2189 Prot., datë 03.03.2021, pra brenda periudhës së fushatës zgjedhore dhe për rrjedhojë brenda afatit të parashikuar në nenin 91 pika 3 të K.Zgjedhor.
6. Në këto kushte, shoqëria “Albpetrol” sh.a. kishte detyrimin që duke qenë se zgjidhja e kontratës së punës është kryer gjatë fushatës zgjedhore, ta justifikonte zgjidhjen si rrjedhojë të shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës e në këtë rast legjislacioni përkatës është K. Punës dhe shkelje sipas K. Punës konsiderohen ato elemente të parashikuar në nenin 153 të tij që më konkretisht parashikon se:

¹ “3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet Brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.

² “Gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.

“1. Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.

2. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

3. Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit”.

7. Më konkretisht, në rastin objekt shqyrtimi administrativ, shoqëria “Albpetrol” sh.a. nuk ka arsyetuar asnjë shkelje të ankuesit, por e lidh me strukturën e re organizative të punëdhënësit dhe arsimimin e ankuesit, çka do të thotë që asnjë prej këtyre elementeve nuk mund të konsiderohet si shkak i justifikuar.
8. Për sa më sipër, për ne anëtarët e pakicës, zgjidhja e kontratës së punës ndaj ankuesit nuk mund të konsiderohet si e përligjur në kuptim të nenit 91 pika 3 të K. Zgjedhor.
9. Argumenti i anëtarëve të shumicës në KAS se *“Gjatë shqyrtimit të seancës anëtarët e KAS-it i’u drejtuan disa pyetje z. Derhemi, i cili me pretendimet e tij nuk arriti të provonte se njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është veprimtari e ndaluar dhe të jetë në kundërshtim me vendimin nr.9/2020 të Komisionit Rregullator”* është i pabazuar në K. Zgjedhor e për më tepër bie ndesh me qëllimin e nenit 91 të K. Zgjedhor si dhe me qëllimin e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
10. Në interpretim të nenit 91 pika 3, të K. Zgjedhor, barra e provës nuk mund të kalojë te ankuesi/punëmarrësi pasi vetë dispozita e ka parashikuar që vetëm për shkaqe të përligjura mund të zgjidhet kontrata e punës gjatë periudhës së fushatës zgjedhore e për këtë arsye shkaqet e përligjura duhet të provohen nga punëdhënësi. Në rastin objekt shqyrtimi administrativ, për aq kohë sa shoqëria “Albpetrol” sh.a. dështoi të provonte ndonjë shkak të përligjur që kishte lidhje me veprimet apo mosveprimet e ankuesit Andi Derhemi, në kuptim të nenit 153 të K. Punës, atëherë qëllimi i ligjvënësit ka qenë që në këtë rast zgjidhja e kontratës së punës të konsiderohet *apriori* si veprimtari e ndaluar. Një zgjidhje jo e përligjur e kontratës së punës gjatë periudhës së fushatës zgjedhore konsiderohet si përdorim ose vënie në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje e burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti



zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

11. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për moskonsiderimin si veprimtari e ndaluar të zgjidhjes së kontratës së punës në dëm të ankuesit Andi Derhemi gjatë periudhës së fushatës zgjedhore është i kundërligjshëm dhe për rrjedhojë edhe vendimi i marrë nga KAS për lënien në fuqi të tij është një vendim i pabazuar në prova e në ligj.

Ledio BRAHO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

